



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 378, datë 21.6.2023

P Ë R

KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË
SË DREJTËSISË, PËR PROKURORINË E POSAÇME,
DHE REVOKIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË BASHKISË
TIRANË, SHOQËRISË “UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE TIRANË”,
SH.A., TË PASURISË NR.8/123, NË ZONËN KADASTRALE 8330

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “a”, të nenit 8/a, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë, për Prokurorinë e Posaçme, dhe revokimin e së drejtës së pronësisë Bashkisë Tiranë, shoqërisë “Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë”, sh.a., të pasurisë nr.8/123, në zonën kadastrale 8330, me emërtimin “Inkubatori i biznesit”, Tiranë, me qëllim sigurimin e ambienteve të punës për Prokurorinë e Posaçme, sipas certifikatës së regjistrimit, kartelës së pasurisë dhe fragmentit të hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.
2. Kalimi në përgjegjësi administrimi i pronës të Ministria e Drejtësisë, për Prokurorinë e Posaçme, sipas pikës 1, të këtij vendimi, bëhet duke përfshirë të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindin nga ndërtimi i objektit mbi këtë pronë, sipas lejes së ndërtimit nr.S-6519/6, miratuar me vendimin nr.S-6519/7, datë 8.10.2020, të kryetarit të Bashkisë Tiranë.
3. Prokuroria e Posaçme është përgjegjëse për ndjekjen dhe përfundimin e të gjitha procedurave sipas legjislacionit në fuqi deri në regjistrimin e objektit.

4. Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë së Posaçme i ndalohet ndryshimi i destinacionit të përdorimit të pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, tjetërsimi ose dhënia në përdorim të tretëve.
5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Posaçme, Bashkia Tiranë, shoqëria "Ujësjellës-Kanalizime Tiranë", sh.a., dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

ED I R A M A

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

MINISTRI I DREJTËSISË

ULSI MANJA